




NEW HORIZON
Civil Society Organization



Qendra për punë sociale
ULQIN



UDHËZUES

për prindërit e fëmijëve
me nevoja të veçanta



**Slovak Aid**

SHËNIME HYRËSE

Fëmijët me nevoja të veçanta janë më pak të kyçur në sistemet ekzistuese të mbrojtjes sociale të fëmijëve, të mbrojtjes shëndetësore si dhe në sistemin e arsimit. Është shumë e rëndësishme që këta fëmijë më shumë të përfshihen në sistemet ekzistuese, në mënyrë që të mbështetet institucionalizimi i tyre dhe t'u përmirësohet cilësia e jetës, si në familje ashtu edhe në mjedisin lokal. Që të përmirësohet realizimi i të drejtave të garantuara nga shteti për fëmijët me pengesa në zhvillim, prindërit e tyre duhet të jenë të informuar për to dhe për mënyrat e realizimit të tyre.

Këtë udhëzues e kemi paramenduar ashtu që të përfshijë fushat kryesore të cilat i kemi konsideruar si relevante për realizimin e të drejtave të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe familjeve të tyre. Në kuadër të këtyre fushave (mbrojtja sociale, shkollimi, shëndeti) vëmendjen më të madhe ia kemi kushtuar mënyrës së realizimit të të drejtave, institucioneve në të cilat këto të drejta realizohen si dhe proceduarve që duhet ndjekur.

Shpresojmë që ky publikim t'iu shërbejë prindërve si një inkurajim dhe nxitje pozitive në situata kur, ndoshta për një moment, dorëzohen mbas të gjitha përpjekjeve.

Dëshirojmë t'ju inkurajojmë se edhe ju si prindër, përmes angazhimit tuaj mund të ndikoni në përmirësimin e kushteve në të cilat ju dhe fëmijët tuaj, si dhe të gjithë qytetarët e këtij vendi do të jetojnë në mënyrë humane dhe tolerante. Është jashtëzakonisht e rëndësishme të jeni aktiv, të bashkoheni, të bëni ndikim tek njerëzit kompetent për fushat e caktuara që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të fëmijëve tuaj, tek ata që ushtrojnë pushtetin, tek partitë politike dhe organizatat tjera, që me ligje dhe vendime të mundësohet realizimi i plotë i të drejtave tuaja dhe të fëmijëve tuaj.

Edhe pse ky udhëzues mund të këtë mangësi ose ndoshta nuk do të përgjigjet në të gjitha pyetjet tuaja, shpresojmë se si hap i parë do të jetë i mjaftueshëm të motivojë më shumë njerëz që në të ardhmen të krijojmë një edhe më të mirë, me më shumë informacione.

Titulli i projektit:
“NDIHMA TË CILËN UNË E KUPTOJ”

Realizues:
**Organizata e shoqërisë civile
“HORIZONTI i RI” Ulqin**
Tel/Fax: +382 30 411 969
Mob: +382 68 300 603
E-mail: ngohorizonti@t-com.me
www.ngo-horizonti.org

UDHËZUES

për prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta

Ulqin, 2011.



Botimin e këtij udhëzuesi e mundësoi **Agjencia sllovaqe për zhvillim dhe bashkëpunim ndërkombëtar– SLOVAK AID**, në kuadër të projektit të gjerë «*Ndihma të cilën unë e kuptoj*», i cili realizohet në pjesën rurale të komunës së Uqinit (*Ana e Malit*). Projekti iu dedikohet fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe prindërve të tyre.

Ky udhëzues u përgatit në partneritet të ngusht me **Qendrën për punë sociale - Ulqin**.

Të nderuar prindër, fëmija Juaj, si të gjithë fëmijët e tjerë, ka të drejtë të duhet dhe të respektohet

Kjo do të thotë që maksimalisht të respektohen të gjitha mundësitë, nevojat, ndjenjat, interesimet e tija dhe se si i tillë ai do të jetë i vlefshëm dhe i rëndësishëm për ju dhe për të gjithë ne.

të jetojë me familjen e vetë

Kjo do të thotë se edhe shteti merr mbi vete pjesën e përgjegjesisë në mënyrë që familjes së fëmijës me pengesa në zhvillim t'i ndihmohet që sa më lehtë t'i përjetojë vështirësitë dhe problemet e përditshme dhe kështu të sigurojë ruajtjen e familjes. Shoqëria në tërësi duhet tu përgjigjet në mënyrë më adekuate nevojave të familjeve të fëmijëve me nevoja të veçanta, të cilat, ndonëse përballën me probleme të shumta, mbeten stabile dhe harmonike. Sistemet ekzistuese gjithashtu bëjnë përpjekje t'i përgjigjen kësaj çështjeje komplekse.

Të jesh prind i fëmijës i cili, për shkak të pengesave që ka është i izoluar dhe i marginalizuar, do të thotë të jesh në betejën e përhershme për mbijetesë fizike (të paguash ilaçet, trajtime mjekësore speciale, orë private, transport, të bësh mungesa në punë ose edhe të mbetesh pa të, sepse dikush duhet të kujdesohet për fëmijën i cili, për shkak të mospërfshirjes së përgjithshme, duhet të qëndrojë në shtëpi).

Fëmija me pengesa në zhvillim ka të drejtë për kujdes, arsimim dhe edukim të veçantë të cilët do t'i ndihmojnë të jetojë një jetë të mbushur dhe dinjitoze dhe të realizojë shkallën më të lartë të mundshme të pavarësisë dhe pjesëmarrjes shoqërore.

Kushtetuta e Malit të Zi (neni 68) garanton mbrojtjen e veçantë të personave me invaliditet, kurse *Ligji mbi mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve* dhe aktet përcjellëse nënligjore, përcaktojnë të drejtat për mbështetje të fëmijëve me pengesa në zhvillim dhe familjeve të tyre. Përveç këtij ligji, edhe një sërë ligjeve tjerë (*Ligji mbi mbrojtjen shëndetësore, Ligji mbi sigurimin shëndetësor dhe Ligji mbi realizimin e të drejtave të personave me sëmundje mentale, Ligji mbi punësimin e personave me invaliditet etj.*) bëjnë rregullimin e të drejtave të personave me invaliditet dhe fëmijëve me nevoja të veçanta. Të drejtën mbi arsimimin e fëmijëve me pengesa në zhvillim, përveç ligjeve të përgjithshme nga fusha e arsimit, e rregullon edhe *Ligji mbi edukimin dhe arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta*.

Djemtë dhe vajzat me pengesa në zhvillim kanë të drejta të njëjta sikur të gjithë fëmijët e tjerë.

Për shembull, çdo fëmijë ka të drejtë të shkojë në shkollë të luaj dhe të jetë i mbrojtur nga dhuna si dhe të jetë i përfshirë në vendimmarrjen për gjërat që ndikojnë tek ai. Organet përgjegjëse shtetërore duhet të sigurojnë informacione të mjaftueshme dhe mbështetje për fëmijët me pengesa në zhvillim, që ata t'i realizojnë të drejtat e veta.

TË DREJTAT E FËMIJËVE ME PENGESA NË ZHVILLIM

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka aprovuar në vitin 1989. Konventën mbi të drejtat e fëmijëve, që është dokumenti i parë ndërkombëtar i cili trajton të drejtat e fëmijëve në veçanti. Deri në miratimin e kësaj konvente, fëmijët janë konsideruar si mjaft të mbrojtur, në kuadër të mbrojtjes së përgjithshme të familjes. Emri i popullarizuar i Konventës është edhe **Kushtetuta e fëmijëve**. Të drejtat e fëmijëve, për mbrojtjen e të cilave janë obliguar të gjitha vendet që kanë ratifikuar këtë Konventë, përfshijnë absolutisht çdo fëmijë. Megjithatë, duhet të theksojmë se kur flasim për fëmijët me pengesa në zhvillim, këmbëngulja për respektimin e të drejtave të fëmijëve ka rëndësi edhe më të madhe, sepse ata janë pjesa më e ndjeshme e popullsisë.

Konventa mbi të drejtat e fëmijëve jep këtë definicion të fëmijës:

“Fëmijë konsiderohet çdo qenie njerëzore që ende nuk i ka mbushur 18 vjet, nëse ligji që trajton fëmijët nuk përcakton arritjen e moshës madhore më herët.

Ndalohet çdo diskriminim i fëmijëve në bazë të invaliditetit dhe kërkohen masa të veçanta për sigurimin e të drejtave të fëmijëve”

Pasi fjala këtu është për standardet ndërkombëtare, asnjë shtet që ka ratifikuar Konventën nuk mund të deklaroj se trajtimi i të drejtave të fëmijëve është çështje e brendshme e tij.

Mali i Zi ka ratifikuar Konventën mbi të drejtat e fëmijëve me 23. tetor 2006, kurse në dhjetor është bërë konfirmimi i Kartës sociale Evropiane – e cila përfaqëson një nga instrumentet thelbësor ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave sociale, ekonomike dhe kulturore në Evropë.

Karta sociale Evropiane, si instrument komplementar i Konventës Evropiane mbi të drejtat e njeriut e cila mbron të drejtat qytetare dhe politike, avancojnë mbrojtjen e të drejtave themelore sociale dhe ekonomike të qytetarëve të vendeve nënshkruese. Karta gjithashtu krijon mekanizma të cilët garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga shtetet - palët kontraktuese.

Shtetet janë përgjegjëse për krijimin e mundësive dhe hapësirave ligjore të cilat synojnë përfshirjen e plotë dhe barazinë e plotë të personave me invaliditet.

Sipas rregullave standarde të Kombeve të Bashkuara për barazimin e mundësive që ju jepen personave me invaliditet, legjislacioni kombëtar i cili rregullon të drejtat dhe obligimet e qytetarëve do të duhej të përfshijë edhe të drejtat dhe obligimet e personave me invaliditet. Shtetet kanë obligim t’iu mundësojnë personave me invaliditet shfrytëzimin e të drejtave të tyre, duke përfshirë këtu edhe të drejtat e tyre njerëzore dhe qytetare, në baza të barabarta me qytetarët tjerë.

SI TË DALLOHET FËMIJA ME PENGESA NË ZHVILLIM

	PENGESAT E MUNDSHME NË MOTORIKËN THEMELORE
0-1 muaj	Tepër i qetë, i ngathët, nervoz, i kërrusur, koka gjithmonë e kthyer në një anë
4-6 muaj	Në pozicion të ngritur këmbët i mbanë të kryqëzuara
24 muajsh	Preokupim me një aktivitet që përsëritet (lëkundje, luhatje, kërcim, tundje me duar, sjellje në rreth)
3 vjeç	Gjithmonë në lëvizje, hiperaktiv, motorikisht i paaftë, ngatërrohet dhe shpesh herë rrëzohet
	PENGESAT E MUNDSHME NË ZHVILLIMIN E MOTORIKËS
24 muajsh	Me vështirësi i mban gjërat, duart e lodhura
	PENGESAT E MUNDSHME NË ZHVILLIMIN E TË DËGJUARIT DHE TË PAMURIT
4 muajsh	Nuk reagon në tinguj
9 muajsh	Mungojnë reagimet në tingujt më të ulët
5 vjeç	Përqendrimi i dobët i vëmendjes së të dëgjuarit dhe të pamurit
	PENGESAT E MUNDSHME NË ZHVILLIMIN E AFTËSIVE INTELEKTUALE
7 muajsh	Nuk tregon interes për objektet që e rrethojnë
12 muajsh	Nuk i hulumton objektet, por i fut në gojë
3-4 vjeç	Me vështirësi ballafaqohet me kërkesat pedagogjike në kopsht
	PENGESAT E MUNDSHME NË ZHVILLIMIN E AFTËSIVE TË TË FOLURIT
24 muajsh	Të folurit e penguar; nuk flet dhe nuk e kupton të folurit
36 muajsh	Belbëzim
4-5 vjeç	Të folurit pa gramatikë
	PENGESAT E MUNDSHME NË ZHVILLIMIN SOCIAL DHE EMOCIONAL
0-3 muaj	Qanë pa arsye me zë të ngjirur
4 muajsh	Flenë dhe merr ushqimin pa ndonjë rend, shpesh vjell
12 muajsh	Nuk iu përgjigjet stimulimeve emocionale nga rrethi, gjendje e gjatë e irrituar, të mekurit emocional, nuk mban kontakt sy në sy
18 muajsh	Të përgjurgurit pa kontroll, të shqetësuarit dhe të qeshurit pa arsye, intervalet e habitjes, lëvizjet stereotipie, depresioni i mundshëm për arsye të ndarjes më të gjatë nga personat e afërt.
24 muajsh	Sulme agresive pa arsye, britma dhe të qeshurit pa arsye
3 vjeç	Agresivitet i pamotivuar ndaj të tjerëve dhe ndaj vetes, frika e paarsyeshme, mungesa e frikës nga rreziqet reale, rivaliteti, shenjat të theksuara izolimi
4 vjeç	Shprehje neurotike: thithjet e gishtit, shkulje flokësh, fërkim i pjesëve të trupit, pamundësia e kontrollit të urinimit, niveli i ulët i tolerancës për frustracion.
5 vjeç	Pamundësia e kontrollimit të nevojës së madhe, çrregullime në ushqim

TË DREJTAT THEMELORE NGA FUSHA E MBROJTJES SOCIALE dhe e MBROJTJES SË FËMIJËVE

Mbrojtja sociale e personave me invaliditet dhe fëmijëve me pengesa në zhvillim në Mal të Zi është e rregulluar me *Ligjin mbi mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve* si dhe me ligjet tjera që e rregullojnë këtë fushë.

Ligji mbi mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve parashikon ndihmë për prindërit e fëmijëve me pengesa në zhvillim, në mënyrë që fëmija të mbetet në familje. Të drejtat themelore nga mbrojtja sociale mes të tjerave, janë: ***sigurimi material i familjes, kompensimi personal për invaliditet, kujdesi dhe ndihma nga personi tjetër, akomodimi në institucion e tj.***

Qëllimi i mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve është: sigurimi i mbrojtjes së familjes, të individit, fëmijëve në rrezik dhe personat në gjendje të nevojave sociale, respektivisht të përjashtimit social.

Në realizimin e këtyre qëllimeve nevojitet mbrojtja e:

1. *Personave të paaftë për punë dhe materialisht të pasiguruar*
2. *Fëmijëve pa kujdesin e prindërve*
3. *Fëmijëve me pengesa mendore, trupore dhe sensorike (të shqisave)*
4. *Fëmijëve të keqtrajtuar dhe të marginalizuar*
5. *Fëmijëve me çrregullime në sjellje*
6. *Personave me invaliditet*
7. *Personave të moshuar*
8. *Personave dhe familjeve të cilave për shkak të rrethanave të veçanta iu nevojitet një formë e caktuar e mbrojtjes sociale*

Të drejtat nga fusha e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve janë të rregulluara me Ligjin mbi mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve („*Fleta zyrtare e Malit të Zi“ nr 78/05*), me Ligjin familjar („*Fleta zyrtare e Malit të Zi“ nr. 1/07*) si dhe me aktet tjera nënligjore.

TË DREJTAT QË SIGURON SHTETI

1. Sigurimi material i familjes
2. Kompensimi personal për invaliditet
3. Kujdesi dhe ndihma për personin tjetër
4. Akomodimi në institucionin e mbrojtjes sociale
5. Ndhma për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta
6. Ndhma financiare e njëhershme
7. Shtesa për fëmijë

TË DREJTAT QË SIGUROHEN NGA KOMUNA E ULQINIT

- Ndhma në shtëpi
- Ndhma e njëhershme
- Akomodimi ditor për fëmijët dhe të rinjtë me pengesa në zhvillim
- Pajisja e shfrytëzuesve për akomodimin në institucion
- Kompensimi i shpenzimeve për varrim
- E drejta e liritimit nga pjesa e obligimeve për pagesën e shërbimeve komunale
- Kompensimi i shpenzimeve për qëndrimin e fëmijëve në institucione parashkollore.

Kërkesat për realizimin e këtyre të drejtave dorëzohen në Sekretariatën për veprimtarinë shoqërore, ndërtesa e Komunës së Ulqinit (tel. 030 412 650)

Ndarja e mjeteve nga buxheti i Komunës së Ulqinit, për format e veçanta të mbrojtjes sociale të cilat sigurohen përmes realizimit të programeve dhe projekteve të organizatave të personave me invaliditet dhe organizatave humanitare, bëhet për:

- Projektet të cilët kontribuojnë në mbrojtjen, rehabilitimin dhe socializimin e personave në gjendje të nevojës sociale, përmes konkursit publik.

Konkursin publik e shpallë Kryetari i Komunës në mjetet e informimit publik.

LIGJI FAMILJAR GARANTON KËTO TË DREJTA:

- Të drejtën për jetën familjare
- Të drejtat e fëmijëve (principi i interesit më të mirë të fëmijës)
- Të drejtën për ushtrimin e të drejtës prindërore
- Të drejtën e banimit
- Mbrojtjen e veçantë të të drejtave të fëmijës
- Të drejtën për mbajtjen e fëmijëve
- Të drejtën për procedura të veçanta gjyqësore
- Të drejtën për shkollim

KËTO TË DREJTA REALIZOHEN PËRMES KËTYRE INSTITUCIONEVE:

1. Qendra për punë sociale për Tivar dhe Ulqin – Shërbimi ULQIN
2. Institucionet e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve
3. Qendra ditore për fëmijët dhe të rinjtë me pengesa në zhvillim
4. Sekretariati për veprimtari shoqërore i Komunës së Ulqinit

QENDRA PËR PUNË SOCIALE PËR KOMUNAT TIVAR DHE ULQIN SHERBIMI ULQIN

Ne realizim e qëllimit të ekzistencës së vetë, Qendra për punë sociale kryen këto punë në interesin e qytetarëve:

- Është shkalla e parë për zgjidhjen e kërkesave për realizimin e të drejtave të caktuara nga fusha e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve,
- Bën organizimin dhe implementimin e formave përkatëse të mbrojtjes sociale në territorin e Komunës së Ulqinit,
- Kryen punët e organeve të kujdestarisë në Komunën e Ulqinit,
- Përcjell dhe analizon dukuritë dhe problemet me rëndësi për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve,
- Nxitë, organizon dhe ndërmerr aktivitete me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të problemeve sociale në Komunën e Ulqinit,
- Mban evidencën dhe mbledh dokumentacion për shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve si dhe për format e aplikuara të mbrojtjes sociale në Komunën e Ulqinit,
- Siguron trajtimin profesional të rasteve, ku është e domosdoshme,
- Bën pagimin e kompensimeve të mbrojtjes sociale,
- Zhvillon dhe avancoon format jointucionale të mbrojtjes sociale,
- Mban evidencë dhe dokumentacion për shërbimet që ofron, masat që ndërmerr në kuadër të veprimtarisë së vetë,
- Kryen dhe punë të tjera të caktuara me ligj dhe akte nënligjore.

SIGURIMI MATERIAL I FAMILJES

Të drejtën për sigurimin material të familjes mund ta realizoj ajo familje, respektivisht anëtar i familjes në rast se është i/e paaftë për punë. E drejta për sigurimin social përcaktohet në raport me të ardhurat dhe pasurinë e të gjithë anëtarëve të familjes, kështu që këtë të drejtë mund ta realizoj e gjithë familja.

Ligji mbi mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve si dhe Rregullorja mbi kushtet më të afërta për realizimin e të drejtave themelore, në mënyrë precize përcaktojnë të drejtat dhe mënyrën e realizimit të tyre, me dokumentacionin e nevojshëm.

Së bashku me kërkesën për realizim e të drejtës për sigurimin material, duhet të dorëzohet:

1) *Personat nga neni 13, paragrafi 1, pika 1 e Ligjit*

- Fëmija deri në 18 vjeç: certifikatën nga libri amzë i të lindurve;
- Fëmija i cili ndjek shkollimin e rregullt në shkollën e mesme: vërtetimin për shkollimin e rregullt, në fillim të çdo viti shkollor, e më së largu deri me 1 tetor të vitit vijues;
- Fëmija nga 15 - 18 vjeç, i cili nuk ndjekë shkollimin e rregullt: vërtetimin që është i regjistruar në evidencën e Entit për punësim të Malit të Zi, të cilin e dorëzon në fillim të çdo tremujorshi, për tremujorshin e kaluar;
- Personi të cilit i është përcaktuar paaftësia për punë në pajtim me Ligjin: raportin, vlerësimin dhe mendimin e komisionit mjeko-social (nga neni 101 I Ligjit);
- Personi mbi 65 vjeç: certifikata nga libri amzë i të lindurve.

2) *Personat nga neni 13, paragrafi 1, pika 2 e Ligjit:*

- Gruaja shtatzënë: raportin e mjekut specialist, të cilin e dorëzon në fillim të çdo tremujorshi;
- Personi vetëmbajtës:
 - *Prindi i ndarë ose në rast kur prindi ka vdekur ose nuk është i njohur, që mbanë (rritë) fëmijën e mitur, respektivisht fëmijën në moshë madhore tek i cili paaftësia për punë ka ndodhur para moshës 18 vjeçare: vendimin e gjyqit mbi divorcin ose certifikatën nga libri amzë i të vdekurve ose vendimin e organit kompetent për besimin në përkujdesje dhe edukim;*
 - *Personi me moshë madhore i paaftë për punë, që nuk ka familjar të cilët sipas ligjit janë të detyruar ta mbajnë ose ka familjar të afërt që nuk kanë mundësi ta mbajnë: vërtetimin mbi afërsinë familjare;*
- Prindi i cili mban (rritë) fëmijën e mitur, respektivisht fëmijën në moshë madhore, tek i cili paaftësia për punë ka ndodhur para moshës 18 vjeçare: certifikatën e lindjes ose raportin dhe mendimin e komisionit mjeko-social mbi paaftësinë për punë;

- Personi i cili ka kryer shkollimin sipas programit arsimor me përshtatje të veçanta: vërtetimin mbi shkollimin e kryer;
- Fëmija pa kujdesin e prindërve: vendimin e organit kompetent.

**Kërkesa për realizimin e këtyre të drejtave dorëzohet në Qendrën për punë sociale – ULQIN.
Informata të hollësishme mund të merrni edhe në tel: 030 412 205.**

KOMPENSIMI PERSONAL PËR INVALIDITET

Të drejtën për kompensimin personal për invaliditet e ka ai person tek i cili paaftësia për një jetë të pavarur ka ndodhur para moshës 18 vjeçare.

Së bashku me kërkesën për realizimin e kompensimit personal për invaliditet, dorëzohen:

- ⇒ Dokumentacioni mjekësor;
- ⇒ Çertifikata nga libri amzë i të lindurve.

Ekzistenca e paaftësisë për punë dhe jetë të pavarur, konstatohet nga komisioni socialo-mjekësor (nga neni 101 i Ligjit) me raport, vlerësim dhe mendim, në bazë të dokumentacionit mjekësor, në pajtim me Rregulloren mbi indikacionet mjekësore për realizimin e të drejtave nga mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve ("Fleta zyrtare e Malit të Zi" nr 3/06). Analizën, vlerësimin dhe mendimin e komisionit mjekso-social, Qendra e siguron sipas obligimit zyrtar.

**Kërkesa për realizimin e kësaj të drejte dorëzohet në Qendrën për punë sociale – ULQIN.
Informata të hollësishme mund të merrni edhe në tel: 030 412 205.**

KUJDESI DHE NDIHMA E PERSONIT TJETËR

Të drejtën mbi kujdesin dhe ndihmën e personit tjetër a ka shfrytëzuesi:

- a) i sigurimit material, të cilit për arsye të dëmtimeve dhe mangësive fizike apo mendore ose moshës apo për arsye të ndryshimeve permanente shëndetësore, i nevojitet kujdesi dhe ndihma e përhershme e personit tjetër, për kryerjen e nevojave themelore jetësore;
- b) i kompensimit personal për invaliditet: personi me pengesa të rënda fizike, mendore dhe sensorike, të cilit i nevojitet kujdesi dhe ndihma e përhershme e personit tjetër për kryerjen e nevojave themelore jetësore. Të drejtën mbi kujdesin dhe ndihmën e personit tjetër mund ta realizoj personi i cili këtë të drejtë nuk e ka realizuar në baza të tjera.

Së bashku me kërkesën për realizimin e kësaj të drejte, dorëzohet:

- ⇒ Dokumentacioni mjekësor;
- ⇒ Çertifikata nga libri amzë i të lindurve;
- ⇒ Vendimin mbi realizimin e të drejtës, për shfrytëzuesin e sigurimit material;
- ⇒ Vendimin mbi realizimin e të drejtës, për shfrytëzuesin e kompensimit personal për invaliditet;
- ⇒ Vërtetimin që kjo e drejtë nuk është realizuar më parë, në baza tjera.

Nevojën për kujdesin e përhershëm dhe ndihmën e personit tjetër, e konstaton komisioni mjeko-social nga neni 101 i Ligjit, përmes raportit, vlerësimit dhe mendimit, në bazë të dokumentacionit mjekësor, në pajtim me Rregulloren mbi indikacionet mjekësore për realizimin e të drejtave nga fusha e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve. Raportin, vlerësimin dhe mendimin e komisionit mjeko-social, Qendra e siguron sipas obligimit zyrtar.

***Kërkesa për realizimin e kësaj të drejte dorëzohet në Qendrën për punë sociale – ULQIN.
Informata të hollësishme mund të merrni edhe në tel: 030 412 205.***

VENDOSJA NË INSTITUCION

Së bashku me kërkesën për realizimin e të drejtës së vendosjes në institucion, dorëzohet:

- ⇒ Çertifikata nga libri amzë i të lindurve;
- ⇒ Dokumentacioni mjekësor;
- ⇒ Vërtetimi mbi të ardhurat dhe pasurinë;
- ⇒ Dëshmi të tjera të përcaktuara me aktin e përgjithshëm të institucionit ku realizohet vendosja.

VENDOSJA NË FAMILJE TJETËR

Së bashku me kërkesën për realizimin e të drejtës për vendosje në një familje tjetër, dorëzohen:

- ⇒ Çertifikata nga libri amzë i të lindurve;
- ⇒ Dokumentacioni mjekësor;
- ⇒ Vërtetimi mbi të ardhurat dhe pasurinë;
- ⇒ Dëshmia mbi kujdestarinë.

NDIHMJA PËR EDUKIMIN DHE ARSIMIMIN E FËMIJËVE DHE TË RINJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Së bashku me kërkesën për realizimin e së drejtës për ndihmë në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta, dorëzohen:

- ⇒ Vendimi për orientim në programin arsimor, në pajtim me ligjin;
- ⇒ Dëshmia e vendbanimit
- ⇒ Vërtetimi për të ardhurat dhe pasurinë;
- ⇒ Vërtetimi për vendosje në institucion;
- ⇒ Vërtetimi për shpenzimet e transportit publik.

**Kërkesa për realizimin e këtyre të drejtave dorëzohet në Qendrën për punë sociale – ULQIN.
Informata të hollësishme mund të merrni edhe në tel: 030 412 205.**

NDIHMA FINANCIARE E NJËHERSHME

Për realizimin e të drejtës për ndihmën financiare të njëhershme, së bashku me kërkesën duhet të dorëzohet dëshmia për gjendjen banesore, materiale dhe shëndetësore.

Qendra mund ta realizoj ndihmën financiare të njëhershme në kundërvlerë të mallit, nëse e vlerëson si më të mirë për shfrytëzuesin.

Vlera e ndihmës financiare të njëhershme përcaktohet në bazë të anamnezës sociale dhe mundësive materiale të shtetit.

SHTESA PËR FËMIJË

Shtesa për fëmijë është një nga të drejtat themelore të mbrojtjes së fëmijëve. Të drejtën në shtesën për fëmijë mund ta realizoj: fëmija i shfrytëzuesit të sigurimit material; fëmija me pengesa fizike, mendore dhe sensorike, i cili mund të aftësohet për punë dhe jetë të pavarur; fëmija me pengesa fizike, mendore dhe sensorike, i cili nuk mund të aftësohet për punë dhe jetë të pavarur.

Së bashku me kërkesën për realizimin e të drejtës për shtesën për fëmijë, dorëzohen:

- dëshmia mbi vendbanimin e prindërve, kujdestarëve ose personave të cilëve u është besuar kujdesi, edukimi dhe aftësimi i fëmijës;
- Çertifikata nga libri amzë i të lindurve, për të gjithë fëmijët;
- Për fëmijët e shfrytëzuesve të sigurimit material të familjes: vendimi për realizimin e kësaj të drejte;
- Për fëmijët me pengesa fizike, mendore dhe sensorike, të cilët mund të aftësohen për punë dhe jetë të pavarur si dhe për fëmijët me pengesa fizike, mendore dhe të sensorike, të cilët nuk mund të aftësohen për punë dhe jetë të pavarur: vendimi mbi orientimin në programin arsimor, në pajtim me ligjin;
- Për fëmijët pa kujdestari të prindërve: vendimi i organit kompetent;
- Për fëmijët që ndjekin shkollimin e rregullt në shollën e mesme: vërtetimin për shkollimin e rregullt;
- Për fëmijën nga moshën 15 - 18 vjeç, i cili nuk ndjek shkollimin e rregullt: vërtetimin që gjendet në evidencën e Entit për punësim të Malit të Zi

***Kërkesa për realizimin e këtyre të drejtave dorëzohet në Qendrën për punë sociale – ULQIN.
Informata të hollësishme mund të merrni edhe në tel: 030 412 205.***

Mbrojtja sociale dhe shëndetësore

Si mund ta realizoj të drejtën në mbrojtjen shëndetësore

Nevojitet të nxirri librezën shëndetësore dhe të hapni kartonin shëndetësor në Shtëpinë e shëndetit në vendbanimin tuaj.

A ka të drejtë i ati i fëmijës të sëmurë, të marr pushim mjekësor dhe a i zvogëlohet rroga për ditët që i ka kaluar në pushimin mjekësor?

Natyrisht, babai dhe nëna janë të barabartë para ligjit në këtë rast. Për zvogëlimin e të ardhurave duhet të pyesni shërbimin juridik të punëdhënësit. Gjithashtu, babai mund ta marr edhe pushimin të cilën zakonisht e shfrytëzojnë nënat kur lindin. Tre muajt e parë nga lindja, gruaja ndodhet në pushimin e lindjes. Nëntë muajt e ardhshëm në fakt quhen “pushim për kujdesin ndaj fëmijës” dhe këto nëntë muajt mund t'i shfrytëzojë edhe babai në vend të nënës.

Sa kohë ka të drejtë nëna e fëmijës me pengesa në zhvillim të jetë në pushimin e lindjes?

Kohëzgjatja e pushimit të lindjes të nënës së fëmijës me pengesa në zhvillim është e njëjtë sikur e të gjitha nënave. Megjithatë, të drejtën të punoj gjysmën e orarit të punës e ka prindi, adoptuesi apo personi të cilit organi kompetent ia ka besuar në kujdes fëmijën me pengesa në zhvillim, respektivisht personi i cili kujdeset për personin me invaliditet të rëndë, deri në moshën tri vjeçare të fëmijës (në bazë të vlerësimit dhe mendimit të komisionit mjeko-social). Kërkesa i dorëzohet punëdhënësit, ndërsa punëdhënësi është i obliguar që kërkesën t'ia dorëzojë Qendrës për punë sociale. Në bazë të analizave dhe mendimit të komisionit mjeko-social, Qendra sjell vendimin. Në bazë të këtij vendimi, punëdhënësit i bëhet rimbursimi i rrogës bruto . Në këtë mënyrë shteti mbron nënat, respektivisht prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Cilat janë të drejtat që realizohen në komisionin mjekësor?

Komisioni mjekësor jep vlerësimin e aftësive të punës në raste të paftësisë së përkohshme për punë; vlerëson nevojën për shoqëruesin gjatë trajtimit spitalor; jep mendim për udhëzimin në mjekim jashtë territorit të filialit tonë, për kompensimin e shpenzimeve të mjekimit dhe shpenzimeve të transportit si dhe për rimbursimin e mjeteve për blerjen e ilaçeve nga lista pozitive (në rast se ilaçi i caktuar nuk gjendet në farmacitë shtetërore).

■ PËRGJIGJET NË PYETJET MË TË SHPESHTA

≡ Dokumentacioni personal ≡

Ku nxirret çertifikata nga libri amzë i të lindurve?

Çertifikata nxirret në Ministrinë e punëve të brendshme dhe të administratës publike – filiali Ulqin.

Si është procedura për nxjerrjen e çertifikatës nga libri amzë i të lindurve dhe vërtetimin e shtetësisë?

Prindi plotëson formularin për fëmijën (në sportelet e këtij Shërbimi)

Si ta bëj regjistrim e mëvonshëm në librin amzë të të lindurve?

Duhet të kontaktoni Ministrinë e punëve të brendshme dhe administratës publike – filiali Ulqin. Ata do t'ju udhëzojnë në procedurën e duhur.

Si ta nxjerrë letërnjoftimin?

Kërkesa për dhënien e letërnjoftimit i dorëzohet filialit/organit për punët e brendshme administrative ku qytetari ka vendbanimin – në rastin tonë bëhet fjalë për filialin në Ulqin.

Dorëzimi i kërkesës dhe marrja e letërnjoftimit, bëhet personalisht. Qytetari me nënshkrimin e vet konfirmon vërtetësinë e të dhënave në formularin për dhënien e letërnjoftimit.

Për dhënien e letërnjoftimit duhet të dorëzohet: *kërkesa (formulari merret në filialin për punët e brendshme administrative) dhe vërtetimi i pagesës për formular (informacionet për mënyrën e pagesës mund t'i gjeni në tabelat e shpalljeve dhe sportelet e këtij Shërbimi).*

Si mund ta marr vërtetimin për vendbanim?

Me dokumentin identifikues (letërnjoftim, pasaportë, leja e qarkullimit) duhet të shkoni në sportelet e Ministrisë së punëve të brendshme dhe të administratës publike, filiali Ulqin.

Çfarë është ndihma sociale dhe kush mund ta realizoj?

Ndihma sociale është shprehje e cila në të folurit e përditshëm përdoret për të dalluar format e ndryshme të ndihmave nga fusha e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve.

Këtij grupi i përkasin “ndihma e njëhershme” dhe “sigurimi material i familjes” të cilët realizohen përmes Qendrës për punë sociale. Ekzistojnë edhe format tjera të ndihmës që komunat ia ofrojnë popullatës që është e marginalizuar, por këto ndihma dallohen nga komuna në komunë.

Kontaktoni Qendrën për punë sociale, ku do të informoheni më për së afërmi për kushtet e realizimit të këtyre të drejtave.

Nëse në familje ekziston një fëmijë me invaliditet, çfarë dokumentacioni nevojitet për realizimin e shtesës për fëmijë?

Letërnjoftimet e prindërve, certifikata e lindjes për fëmijën si dhe vendimi i Komisionit për orientimin e fëmijëve me nevoja të veçanta apo vendimi i Qendrës për punë sociale që fëmija është shfrytëzues i “kujdesit të personit tjetër” apo i “kompensimit personal për invaliditet”.

A është më e lartë “shtesa për fëmijë” për fëmijët me invaliditet?

Shtesa për fëmijë realizohet në pajtim me Ligjin mbi mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve. Fëmijët me invaliditet kanë të drejtë në shtesën për fëmijë.

Për fëmijën me pengesa mendore dhe sensorike, që mund të aftësohen për punë dhe jetë të pavarur, shtesa për fëmijë është 20 euro, kurse për fëmijën që nuk mund të aftësohet për punë dhe jetë të pavarur, shtesa për fëmijë është 25 euro. Procedura për realizimin e kësaj të drejte është e përshkruar në kapitullin “shtesa për fëmijë”.

Kush mund ta realizoj të drejtën për ndihmën dhe kujdesin e personit tjetër dhe kompensimin personal për invaliditet?

Kërkesa i dorëzohet Qendrës për punë sociale, e cila sjell vendimin sipas raportit dhe vlerësimit të komisionit mjeko-social. Në Qendrën për punë sociale do të merrni të gjitha informacionet e nevojshme për dokumentacionin që kërkohet (për rastin tuaj konkret), së bashku me formularin e plotësuar për realizimin e kësaj të drejte.

Arsimi

A mund të ndjekin kopshtin fëmijët me pengesa në zhvillim?

Fëmijët me pengesa të lehta dhe të mesme, mund të ndjekin kopshtin njëloj sikur edhe të gjithë fëmijët tjerë, me vendim të komisionit përkatës për orientimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Çfarë nevojitet për regjistrimin e këtyre fëmijëve në kopsht?

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në institucionin parashkollor është i njëjtë për të gjithë fëmijët dhe ai nënkupton: paraqitjen në konkurs, çertifikatën nga libri amzë i të lindurve, vendimi i komisionit për orientimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Kriteret për regjistrim janë të njëjta për të gjithë fëmijët.

Cila është mosha më e mirë për ta regjistruar fëmijën me pengesa në zhvillim?

Nuk ka një rregull të përcaktuar. I rëndësishëm është vlerësimi individual i momentit për përfshirjen në kopsht, të fëmijës me pengesa në zhvillim. Sipas rekomandimeve të eksperteve është mirë të implementohet programi i intervenimit të hershëm, të përcaktohet koha më e mirë për regjistrimin e fëmijës në kopsht, në bashkëpunim me prindërit dhe në pajtim me nevojat e fëmijës.

Si ta regjistroj fëmijën në shkollë?

Ju nevojiten: Çertifikata nga libri amzë i të lindurve (për fëmijën), vendimi i Komisionit për orientimin e fëmijës me nevoja të veçanta, vërtetimi i pediatrit që fëmija është vaksinuar rregullisht. Gjithsesi, është e nevojshme të kontaktoni shkollën në të cilën planifikoni ta regjistroni fëmijën ose t'i përmbaheni vendimit të Komisionit për orientimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Çfarë është testimi për regjistrim në shkollë?

Ky është një vlerësim i njohurive, aftësive, pjekurisë sociale dhe gatishmërisë për të ndjekur shkollën, që fëmija sjell nga institucioni parashkollor dhe familja. Bëhet testimi i aftësive të tija të dallojë objektet themelore dhe ambientin rreth tij. Me këtë vlerësohet se a është fëmija i gatshëm të filloj shkollimin apo nevojitet edhe një vit që fëmija të aftësohet në mënyrë psikike, për të përcjellë mësimin shkollor. Gjatë këtij testimi gjithashtu vlerësohet se a është fëmija i aftë ta ndjekë shkollimin e rregullt ose ka ndonjë pengesë për shkak të së cilës i nevojitet përcjellje individuale ose duhet të udhëzohet në Komisionin për orientimin e fëmijëve me nevoja të veçanta (*dikur: "kategorizim"*).

Çfarë është klasifikimi / kategorizimi?

Në rast se shërbimi profesional i shkollës, gjatë testimit për klasën e parë, konstaton se fëmija nuk ashtë i gatshëm për fillimin e shkollës, atëherë e dërgon në testim plotësues. Nëse vërehet se fëmija ka pengesa të caktuara (dëmtimi i të dëgjuarit, të folurit, të shikimit apo ndonjë formë të mangësive intelektuale), atëherë fëmija udhëzohet tek Komisioni komunal për kategorizim dhe orientim të fëmijëve me nevoja të veçanta (nëse më parë nuk është kontrolluar te komisioni kompetent).

Nëse gjatë shkollimit vërehet se fëmija ka vështirësi në mësim dhe aplikim të përmbajtjeve/shkathtësive të parapara për moshën e tij, atëherë fëmija udhëzohet për klasifikim dhe konstatohet se a ka nevojë për një përkrahje të veçantë.

Përse duhet të shkoj te Komisionin për kategorizim?

Komisioni për kategorizim në fakt quhet *Komisioni për orientimin e fëmijëve me nevoja të veçanta* dhe kërkesa i dorëzohet Sekretariatit për veprimtarinë shoqërore të Komunës së Ulqinit (në ndërtesën e Komunës). Ky komision vlerëson llojin e pengesës/vështirësisë/invaliditetit që ka fëmija.

A do të shkoni te Komisioni për orientimin e fëmijëve me nevoja të veçanta apo jo, ky është vendim vetëm i juaji. Megjithatë, duhet të dini se pasojat e mosparaqitjes te ky Komision do të ndikojnë në realizimin e të drejtave të tjera që mund të fitohen në bazë të invaliditetit.

Cila është mosha për të shkuar për herë të parë te Komisioni për kategorizim?

Më së largu deri në moshën e pjekurisë.

Përse shkohet disa herë te Komisioni për kategorizim?

Për të vërtetuar se a ka ndryshime të gjendjes së fëmijës në ndërkohë.

Çfarë do të thotë rikategorizimi?

Rikategorizimi është ndryshimi i kategorisë ku ishit më parë (testohet a është ende e njëjtë shkalla she natyra e pengesave).

Në rast kur personi me invaliditet mbetet të jetojë vetëm, pas vdekjes së prindërve, kush vendos nëse ai mund të jetojë vetëm? A i jepet ky vendim personit me invaliditet? Çfarë ndodh me pasurinë që ky person posedon, nëse vendoset në ndonjë institucion? A mund të kthehet ky person në shtëpi pas disa kohësh dhe të vazhdojë jetë të pavarur ose me një asistent personal?

Personi për këtë vendos vetë, në qoftë se ka moshën madhore dhe është i aftë për arsyetim. Nëse jo, vendos kujdestari i tij ligjor apo Qendra për punë sociale. Prona mbetet në pronësinë e personit me invaliditet.

Familja që ka një anëtar me invaliditet a mund të ketë lehtësime në pagesën e rrymës elektrike?

PO. “Elektro-distribucionit” i dorëzohet kërkesa dhe vërtetimi se fëmija është shfrytëzues i të drejtave të mbrojtjes sociale.

A kanë personat me invaliditet lehtësim për pagesën e telefonit?

PO. Kërkesa i dorëzohet T-com Qendrës (në Ulqin). Së bashku me kërkesën dorëzohet vendimi që personi është shfrytëzues i të drejtave të mbrojtjes sociale.

A kanë personat me invaliditet lehtësime në pagesën e shërbimeve komunale (në komunën e Ulqinit)?

JO!

A ekziston në qytetin tonë ndonjë këshillimore apo institucion që jep informacione për të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta?

Qendra për punë sociale (përveç punëve të rregullta dhe atyre që janë të përcaktuara me Ligj dhe Statut), ofron edhe shërbime të punës sociale. Pra, Qendra ofron edhe shërbime të tilla e që janë pa pagesë. Në Qendër ekziston nëpunësi i ngarkuar, i cili në çdo moment është i gatshëm tu ofroj të gjitha informacionet e nevojshme prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta. E gjithë kjo rrjedh nga *Strategjia për integrimin e personave me invaliditet 2008-2016*, të cilën e ka aprovuar Qeveria e Malit të Zi.